



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

Prishtinë, 20.12.2017

Komunikatë për medie

Dje me datë 19.12.2017 Paneli ka shqyrtuar dhe vendosur të gjitha ankesat e parashtuara në PZAP nga Subjekti Politik - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), lidhur me rivotimin për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Istogut të mbajtura me datë: 17.12.2017.

Ankesat janë shqyrtuar dhe vendosur brenda afatit ligjor prej 72 orëve, afat ky i cili ka filluar dje me datën 18.12.2017 nga ora 19:00 e i cili përfundon ditën e enjte me datën 21.12.2017 në ora 19:00.

13 ankesa janë refuzuar si të pabazuara.  
1 ankesë është hedhur si e palejuar.

Ndaj vendimeve të PZAP-it mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda 24 orëve prej momentit të pranimin të vendimit të PZAP-it. Ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës duhet të vendos lidhur me ankesat brenda 72 orëve prej momentit të dorëzimit të ankesës në Gjykatën Supreme.

Vendimet lidhur me këto ankesa i gjeni të publikuara në ueb faqen e PZAP-it nga vendimi me nr. 1128 deri te vendimi nr. 1141.